



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 42, datë 27.01.2023**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË  
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT  
2017-2019, PËR GJYQTAREN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 27.01.2023, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Brikena Ukperaj dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...},

**VËREN:**

**I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (Ligji për statusin), Vendimin nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr. 645 datë 23.12.2020 “Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021”, me vendimin nr. 177, datë 29.04.2021, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit, relatore znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Në datën 05.05.2021, në bazë të neneve 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin, gjyqtarja është njoftuar nëpërmjet postës elektronike për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre ose të çdo anëtari të Këshillit. Në datën 05.05.2021, gjyqtarja, nëpërmjet postës elektronike ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka shprehur dakordësinë për vlerësuesit e përcaktuar.

Me shkresat nr. 2071/1 prot., datë 10.05.2021, nr. 2071 prot., datë 10.05.2021 dhe nr. 2111 prot., datë 11.05.2021, është kërkuar përkatësisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës dhe ILDKPKI, informacioni dhe raportimi përkatës lidhur me të

dhënat që përbëjnë burime vlerësimi në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares, në kuptim të nenit 77 të Ligjit për Statusin.

Në datën 29.07.2021, gjyqtares dhe kryetares së gjykatës, i është dërguar nëpërmjet postës elektronike njoftimi për plotësimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”.

Me urdhrin me datë 13.10.2021, relatori ka disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares për periudhën e vlerësimit 2017-2019, duke përcaktuar edhe datën e zhvillimit të shortit. Urdhri i është njoftuar gjyqtares, kryetares së gjykatës, si dhe kancelarit të gjykatës, nëpërmjet postës elektronike. Bazuar në urdhrin e relatorit, më datë 21.10.2021, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim.

Pas zhvillimit të shortit, ka vijuar procedura për formimin e dosjes së vlerësimit, nëpërmjet administrimit të dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe hartimin e raportit analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, ka rezultuar se Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.512, datë 21.11.2022, ka vendosur:

- 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magistratit për znj. {...}, për shkak të dorëheqjes së saj.*
- 2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.11.2022.*
- 3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.*
- 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

Vendimi nr.512, datë 21.11.2022 “Për mbarimin e statusit të magistratit për gjyqtaren znj. {...}”, i është njoftuar gjyqtares me shkresën nr.6042/2 prot., datë 23.11.2022, e cila ka konfirmuar marrjen dijeni në datën 24.11.2022. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.<sup>1</sup>

Pas konstatimeve si më sipër, KVEVP në mbledhjen e datës 12.01.2023 ka shqyrtuar propozimin e relatores së procedurës së vlerësimit dhe ka vendosur të miratojë propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, të filluar ndaj gjyqtares {...}, duke ia kaluar për shqyrtim çështjen Mbledhjes Plenare.

---

<sup>1</sup>Kjo referuar paragrafit 9 vendimit nr.603, datë 19.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

## II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Neni 64 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: *“1. Statusi i magistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen”. Më tej, po në Ligjin për Statusin, në nenin 65 përcaktohet se: “Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.*

Këshilli ka miratuar vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ku në nenin 7, parashikohet se: *“Kur Këshilli vendos mbarimin e statusit të një gjyqtari, për veprimtarinë e të cilit ka filluar vlerësimi etik dhe profesional, deklarohet përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar”.*

## III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, ka rezultuar se Këshilli me vendimin nr.512, datë 21.11.2022 ka deklaruar mbarimin e statusit të magistrates për gjyqtaren {...}, për shkak të dorëheqjes së saj. Vendimi për mbarimin e statusit të magistrates {...}, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, ka filluar efektet e tij që prej datës 30.11.2022.

Në ligjin nr. 96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit.

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe situatën faktike të parashtruar më sipër, Këshilli vlerëson se procedura e vlerësimit të etik dhe profesional për ish/gjyqtaren {...}, e filluar me vendimin nr. 177, datë 29.04.2021, duhet të deklarohet e përfunduar pa vendim përfundimtar, për shkak se si objekti ashtu dhe qëllimi i kësaj procedure vlerësimi është bërë i pamundur për tu realizuar.

### PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues, nenet 64, 65 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për

miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, dhe në vendimin nr.512, datë 21.11.2022 “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. {...}”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **V E N D O S I :**

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**